



**#1 QERSHOR NË FAMILJEN E MADHE TË SHËRBIMIT SOCIAL**



Si çdo vit, në familjen e madhe të Shërbimit Social Shtetëror u zhvilluan festimet e 1 Qershorit. Nga të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë u organizua festë me kërcime, këngë e vjersha, pa harruar sigurisht edhe dhuratat.

Kalamaja qoftë e gjithë jeta juaj e gëzuar dhe e bukur si kjo ditë!

**#LORENCI IA DOLI**



Ju prezantojmë me Lorencin i cili ia doli!

Lorenci më parë ka qenë përfitues nga Skema e Ndhmës Ekonomike. Në bashkëpunim me Zyrën e Punës dhe në përmbushje të misionit për ta kthyer skemën e NE nga pasive në aktive, Lorenci u punësua në një subjekt privat në qytetin e tij të banimit!

Punë të mbarë Lorenc!



SHERBIMI SOCIAL

### #DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Qershor 2021 janë mbledhur komisionet për sistemimet në IPSH, nga të cilët janë sistemuar 3 raste emergjente, janë sistemuar 6 të moshuar nga 21 raste të shqyrtuara.

Në mbledhjet e tjera të komisioneve janë rinovuar 43 librezat për statusin e jetimit. Është shqyrtuar dokumentacioni për sistemimin e PAK dhe është sistemuar 1 rast.

Janë ndjekur 3 procese gjyqësore për fëmijë në nevojë dhe për përfitim status jetimi.

### #DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK



Gjatë muajit Qershor 2021 është ndjekur ecuria e skemës së NE në nivel kombëtar dhe dinamika e NE. Është ndjekur procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale, ndërsa verifikimi me SHKP u krye manualisht për shkak të problemeve të sistemit të SHKP.

Është përgatitur dhe hedhur në sistem projekt-raporti i kontrollit të DRSHSSH Tiranë si edhe është zhvilluar kontroll në DRSHSSH Shkodër.

Është kryer kontroll në Zyrën e Komisionit Biopsikosocial në Kombinat.